



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Nr.89**

**2005**

**25 nëntor**

### P Ë R M B A J T J A

|                                            | Faqe                                                                                                                                                                                                                     |
|--------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ligj nr.9437<br>datë 27.10.2005            | Për ratifikimin e “Marrëveshjes së grantit GEF ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim për projektin e zhvillimit të burimeve natyrore”..... 2851 |
| Ligj nr.9438<br>datë 27.10.2005            | Për ratifikimin e “Marrëveshjes ushtarake grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë”..... 2862                                                            |
|                                            | Rezolutë e Kuvendit, datë 21 nëntor 2005..... 2864                                                                                                                                                                       |
| Dekret nr.4703<br>datë 24.11.2005          | Për falje dënimi..... 2865                                                                                                                                                                                               |
| Vendim i KM<br>nr.735, datë 25.11.2005     | Për “disa ndryshime në vendimin nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Ceremonialit Zyrtar të Republikës së Shqipërisë”..... 2867                                                            |
| Vendim i KMBSH<br>nr.88, datë 16.11.2005   | “Për një ndryshim në rregulloren “Për licencimin e subjekteve jobanka””..... 2868                                                                                                                                        |
| Vendim i KMBSH<br>nr.89, datë 16. 11. 2005 | “Për disa ndryshime në udhëzimin “Për blerjet dhe shërbimet në vlerë të vogël në Bankën e Shqipërisë”..... 2868                                                                                                          |
| Vendim i KMBSH<br>nr.90, datë 16. 11. 2005 | “Për disa ndryshime në rregulloren “Për prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe të ndërtimeve në Bankën e Shqipërisë””..... 2869                                                                                        |

**L I G J**  
**Nr.9437, datë 27.10.2005**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË GRANTIT GEF NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE  
PËR RINDËRTIM E ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E ZHVILLIMIT TË BURIMEVE  
NATYRORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja e grantit GEF ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim për projektin e zhvillimit të burimeve natyrore”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4693, datë 11.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJE GRANTI**  
**E FONDIT GLOBAL MJEDISOR**

Marrëveshje e datës \_\_\_\_\_, 2005, midis Shqipërisë (Marrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), si agjenci zbatuese e Fondit Global të Mjedisit, për fondet grant që siguron Fondi i Trusteve GEF për vendet anëtare të bankës pjesëmarrëse në GEF.

Meqenëse A) Banka, në vijim të rezolutës nr.91-5 të 14 marsit 1991 të drejtorëve ekzekutivë të Bankës, ka themeluar GEF për të ndihmuar mbrojtjen e mjedisit global, si dhe për të nxitur një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm nga pikëpamja mjedisore;

B) në vijim të ristrukturimit të GEF, rregullimet vazhduan në bazë të rezolutës nr.94-2 të 24 majit 1994 të drejtorëve ekzekutivë të Bankës, të cilët krijuan Fondin e Trusteve GEF dhe e caktuan Bankën si trust të Fondeve të Trusteve GEF (Rezoluta 94-2);

C) Marrësi, duke qenë i kënaqur me lehtësitë dhe prioritetet e projektit të përshkuara në skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti), ka kërkuar asistencë nga burimet e Fondit GEF për të financuar projektin, dhe kjo kërkesë është miratuar sipas dispozitave të instrumenteve për ristrukturimin e Fondit Global të Mjedisit miratuar me rezolutën 94-2;

D) Marrësi i ka kërkuar gjithashtu Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (Shoqata) të sigurojë fonde plotësuese për të financuar projektin, dhe me anë të një marrëveshjeje të së njëjtës datë midis Marrësit dhe Shoqatës (Marrëveshja e huasë për zhvillim), Shoqata ka pranuar ta sigurojë këtë asistencë të rënë dakord në parim në një sasi prej 4 milionë e gjashtëqind mijë të drejta tërheqjeje speciale (SDR 4 600 000) (Kredia);

E) Marrësi ka për qëllim të kontraktojë me qeverinë e Suedisë (grantit Sida) një sasi prej SEK 40 000 000 për të asistuar financimin e një pjese të projektit në termat dhe kushtet e rëna dakord me anë të një marrëveshjeje midis Marrësit dhe qeverisë së Suedisë (Marrëveshja e grantit Sida);

Meqenëse, Banka ka pranuar që, mbi bazën sa më sipër, t'i japë grantin Marrësit, në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, atëherë palët e më sipërme bien dakord për sa më poshtë:

#### Neni 1

### Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

Seksioni 1.01 (a) Dispozitat që vijojnë nga “Kushtet e përgjithshme të zbatueshme për marrëveshjet e garancisë dhe huasë për huatë në një monedhë të vetme” të Bankës, të datës 30 maji 1995 (bashkë me ndryshimet e bëra asaj më 1 maj 2004), bashkë me modifikimet e vendosura në paragrafin (b) të këtij seksioni (Kushtet e përgjithshme) përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje:

- i) Neni 1
- ii) Seksionet 2.01, (2), (3), (4), (5), (6), (7), (8), (14), (15), (16), (18) dhe (21), 2.02 dhe 2.03;
- iii) Seksioni 3.01;
- iv) Seksioni 4.01 dhe 4.06;
- v) Neni 5;
- vi) Seksionet 6.01, 6.02 [(a)], c, [(d)], (e), (f), (i), (l), (m), (n), (o) dhe (p), 6.03, 6.04 dhe 6.06;
- vii) Seksioni 8.01 (b);
- viii) Seksioni 9.01 (a) dhe (c), 9.04, 9.05, 9.06, 9.07, 9.08 dhe 9.09;
- ix) Seksionet 10.01, 10.03 dhe 10.04;
- x) Neni 11,
- xi) Seksionet 12.01 (c) 12.03 dhe 12.04
- b) Kushtet e përgjithshme do të modifikohen si vijon:
  - i) Termi “Bankë” kudo që përdoret në kushtet e përgjithshme, me përjashtim të seksioneve 2.01 (6), 6.02 (f) dhe 5.01 (a), që këtej e tutje nënkupton Bankën si agjenci zbatuese e GEF-it, me përjashtim të seksionit 6.02, ku termi “Bankë” përfshin gjithashtu Bankën në kapacitetin e vet funksional;
  - ii) Termi “Huamarrës”, kudo që përdoret në kushtet e përgjithshme, nënkupton “Marrësin”;
  - iii) Termi “Marrëveshje e kredisë”, kudo që përdoret në kushtet e përgjithshme, nënkupton këtë Marrëveshje;
  - iv) Termi “Kredi” dhe “kredi”, kudo që përdoret në kushtet e përgjithshme”, nënkupton grantin e (GEF);
  - v) Termi “Llogari e kredisë”, kudo që përdoret në kushtet e përgjithshme”, nënkupton llogarinë e grantit të (GEF);
  - vi) Një nënparagraf i ri është shtuar pas nënparagrafit (o) në seksionin 6.02 të kushteve të përgjithshme, si vijon: “krijimi i një situatë të jashtëzakonshme do të ketë për rrjedhojë një disbursim të mëtejshëm nën grantin e (GEF) duke tejkaluar burimet disponibël për disbursim nga (GEF)”;
  - vii) Fjalët “i korruptuar dhe mashtrues” në paragrafin (c) të seksionit 6.03 janë zëvendësuar me fjalët “i korruptuar, mashtrues, bashkëpunuar ose shtrëngues”.
- Seksioni 1.02. Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje, me përjashtim të rasteve kur e kërkon ndryshe konteksti, termat e përkufizuar në kushtet e përgjithshme dhe në përshkrimet e kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet e rëna dakord si më sipër dhe termat shitesë kanë kuptimet që vijojnë:

a) “Marrëveshja e kredisë së zhvillimit” nënkupton marrëveshjen e së njëjtës datë midis Marrësit dhe Shoqatës për projektin, së bashku me ndryshimet e herëpashershme sipas nevojës dhe këto terma përfshijnë planet dhe marrëveshjet shitesë të Marrëveshjes së kredisë për zhvillim;

b) “Kategori të lejuara” nënkupton kategorinë (1) — (6) të dërguara në tabelën në pjesën A.1 të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje;

c) “Shpenzime të lejuara” nënkupton shpenzimet për mallrat, punimet, shërbimet e konsulencës dhe trajnimet që i referohen seksionit 2.02 të kësaj Marrëveshjeje;

d) “Raporti i monitorimit financiar (GEF FMR)” nënkupton çdo raport të përgatitur në përputhje me seksionin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje;

e) “Llogaria speciale e (GEF)” nënkupton llogarinë që i referohet pjesa B e skedulit 1 të kësaj

Marrëveshjeje;

f) “Raporti bazuar në disbursime” nënkupton opsionin e Marrësit për tërheqjen e fondeve nga llogaria e GEF në pjesën A.5 të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 2

### **Granti i Fondit të GEF**

Seksioni 2.01 Banka bie dakord që të bëjë të disponueshëm për Marrësin, bazuar në termat dhe kushtet e vendosura apo që i referohen kësaj Marrëveshjeje, Grantin e (GEF) në një sasi prej pesë milionë dollarësh (\$ 5 000 000).

Seksioni 2.02 Sasia e grantit (GEF Trust Fund Grant) mund të tërhiqet nga llogaria e grantit (GEF Trust Fund Grant Account) sipas kushteve të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje për shpenzimet e bëra (ose, në qoftë se Banka do të jetë dakord, të bëhen) në përputhje me një kosto të arsyeshme të mallrave, punimeve apo shërbimeve të konsulencës, si dhe trajnimeve të kërkuara nga projekti dhe të financohen nga granti (GEF TFG).

Seksioni 2.03 Data e mbylljes do të jetë 1 nëntor 2010 ose një datë e mëvonshme që Banka do ta vendosë. Banka do të njoftojë menjëherë Marrësin për këtë datë të mëvonshme.

## Neni 3

### **Zbatimi i projektit**

Seksioni 3.01 (a) Marrësi deklaron angazhimin e tij për objektivat e projektit, ashtu siç është përshkruar në skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje, dhe për pasojë do të realizojë projektin me përkushtim dhe efikasitet në përputhje me praktikën e duhura administrative, financiare, mjedisore, pyjore e bujqësore, dhe do të sigurojë menjëherë, sipas nevojës, fondet, lehtësirat dhe shërbimet e tjera burime që do të kërkojnë nga projekti.

b) Pa i kufizuar kushtet e paragrafit (a) të këtij seksioni dhe me përjashtim të rasteve kur Marrësi dhe Banka do të jenë dakord ndryshe, Marrësi do të realizojë projektin në përputhje me programin e zbatimit që është në skedulin 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02 (a) Me përjashtim të rasteve kur Banka do të bjerë dakord ndryshe, prokurimi i mallrave, punimeve (duke përfshirë edhe shërbimet teknike) dhe konsulencave, të kërkuara nga projekti dhe që do të financohen nga granti (GEF TFG), do të qeverisen sipas skedulit 3 të kësaj Marrëveshjeje, ashtu si këto kushte mund të përpunohen më tej në planin e prokurimeve dhe në Manualin e veprimeve të projektit.

b) Marrësi do të miratojë planin e prokurimeve, në përputhje me udhëzuesit e pranueshëm nga Banka, dhe do t’ia dërgojë këtë përditësim Bankës jo më vonë se 12 muaj pas datës paraprirëse të planit të prokurimeve, për aprovim të Bankës.

Seksioni 3.03. Për qëllimet e seksionit 9.08 të kushteve të përgjithshme dhe pa kufizime, Marrësi:

a) do të përgatisë, në bazë të udhëzuesve të pranueshëm nga Banka, dhe do t’i dërgojë Bankës jo më vonë se gjashtë muaj nga data e mbylljes së projektit apo në një datë që do të bihet dakord për këtë qëllim midis Marrësit dhe Bankës, një plan për veprimet e ardhshme të projektit;

b) do t’i japë Bankës një mundësi të arsyeshme për të shkëmbyer pikëpamjet me Marrësin për planin në fjalë.

## Neni 4

### **Marrëveshjet financiare**

Seksioni 4.01 (a) Marrësi do të mirëmbajë një sistem të menaxhimit financiar, duke futur regjistrimet dhe llogaritë, dhe do të paraqesë raportet financiare në përputhje me standardet e llogarisë që aplikohen e janë të pranueshme nga Banka, të përshtatshme për të reflektuar operacionet, burimet dhe shpenzimet në lidhje me projektin.

b) Marrësi:

i) do të ketë raporte financiare, që referohen në paragrafin (a) të këtij seksioni për çdo vit

fiskal (apo periudhë tjetër që do të bihet dakord me Bankën), të auditueshme, në përputhje me standardet që zbatohen për auditimet të pranueshme nga Banka nga auditorë të pavarur të pranueshëm nga Banka;

ii) do t'i sigurojë Bankës, sa më shpejt të jetë e mundur, por në asnjë rast jo më vonë se 6 muaj pas fundit të çdo viti (ose të një periudhe të rënë dakord me Bankën), (A) kopje të certifikuara të raporteve financiare që i referohen paragrafit (a) të këtij seksioni për çdo vit (apo periudhë të rënë dakord nga Banka), ashtu siç auditohen, dhe (B) një opinion për këtë raport nga auditorët në tërësi dhe në detaje të kënaqshme për Bankën;

iii) do t'i sigurojë Bankës të tilla informacione lidhur me regjistrimet dhe llogaritë dhe auditimin e këtyre raporteve financiare prej auditorëve të lartpërmendur, si do t'i kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme.

c) Për të gjitha shpenzimet e lidhura me tërheqjet nga llogaria e grantit (GEF TFGA), që janë bërë në bazë të raporteve që referohen në pjesën A të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje (disbursim i bazuar në raporte) apo në bazë të raporteve të shpenzimeve, Marrësi:

i) do të mbajë së paku për një vit, pasi Banka ka marrë raportin e auditimit, apo të mbulojë vitin fiskal në të cilin është bërë tërheqja e fundit nga llogaria e grantit (GEF TFGA) të gjithë regjistrat (kontratat, urdhrat, faturat, situacionet, aktmarrjet dhe dokumente të tjera) që evidentojnë këto shpenzime;

ii) do t'u krijojë mundësi përfaqësuesve të Bankës t'i kontrollojnë këto regjistra;

iii) të sigurojë që këto regjistra dhe raporte të shpenzimeve janë përfshirë në auditim për çdo vit fiskal (apo periudhë për të cilën bihet dakord me Bankën) që i referohet paragrafit (b) të këtij seksioni.

Seksioni 4.02. (a) Pa kufizime në detyrimet e Marrësit për raporte progresive që janë në paragrafin 3 të skedulit 4 të kësaj Marrëveshjeje, Marrësi do të përgatisë dhe do t'i sigurojë Bankës një raport monitorimi financiar të grantit (GEF), në formë dhe përmbajtje të pëlqyeshme nga Banka që:

i) të vendosë burimet dhe përdorimet e fondeve për projektin, si në formë kumulative, ashtu edhe për periudhën që mbulohet nga raporti, duke paraqitur të ndara fondet që janë siguruar nga granti (GEF TFG), dhe të japë shpjegime për ndryshimet midis përdorimit aktual të fondeve dhe atij të planifikuar;

ii) përshkruan progresin fizik në zbatimin e projektit, në të dyja mënyrat si kumulative ashtu edhe për periudhën e mbuluar nga raporti, dhe shpjegon ndryshimet midis zbatimit aktual dhe planit të zbatimit të projektit;

iii) përshkruan statusin e prokurimeve në projekt, siç është në fund të periudhës që mbulohet nga raporti në fjalë.

b) Raporti i parë i monitorimit financiar (GEF FMR) do t'i dërgohet Bankës jo më vonë se 45 ditë pas fundit të tremujorit të parë pas datës së bërjes efektiv, dhe do të mbulojë periudhën që nga shpenzimi i parë në projekt deri në fund të tremujorit të parë të të njëjtit vit kalendarik, pas kësaj çdo raport i monitorimit financiar do t'i dërgohet Bankës jo më vonë se 45 ditë pas tremujorit pasardhës dhe do ta mbulojë atë tremujor.

## Neni 5

### Zhdëmtimi i Bankës

Seksioni 5.01. Në vijim të seksionit 6.02 (p) të kushteve të përgjithshme, rastet shtesë që vijnë janë specifikuar:

a) i) Subjekt i nënparagrafit (ii) të këtij paragrafi, e drejta e Marrësit të tërheqë shpenzimet nga kredia, bërë nga Marrësi për financimin e projektit, mund të pezullohen, anulohen apo përfundojnë në tërësi apo pjesërisht, në vijim të termave të Marrëveshjes së kredisë për zhvillim.

ii) Nënparagrafi (i) i këtij paragrafi nuk do të aplikohet në qoftë se Marrësi e bind kënaqshëm Bankën që (A) ky pezullim, anulim apo përfundim nuk është shkaktuar nga që Marrësi ka dështuar në realizimin e ndonjë nga detyrimet e parashikuara në Marrëveshjen e kredisë për zhvillim; dhe (B) fondet që duhen për projektin janë të disponueshme te Marrësi nga burime të tjera në termat dhe kushtet që përputhen me detyrimet e Marrësit nën këtë Marrëveshje.

b) Marrësi do të ketë dështuar në realizimin e ndonjërit nga detyrimet nën Marrëveshjen e kredisë për zhvillim.

Neni 6  
**Data e hyrjes në fuqi, përfundimi**

Seksioni 6.01. Rastet që vijojnë janë të specifikuara si një kusht shtesë për efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje brenda kuptimit të seksionit 12.01 (c) të kushteve të përgjithshme, duke konsideruar që Marrëveshja e kredisë për zhvillim ka qenë zbatuar dhe realizuar siç duhet të gjitha kushtet përpara efektivitetit të saj, ose të së drejtës së Marrësit për të bërë tërheqje këtej e tutje, vetëm në rastet , kur efektiviteti i Marrëveshjes së grantit (GEF TFG) është plotësuar.

Seksioni 6.02. Kjo Marrëveshje do të vazhdojë të jetë në fuqi deri sa Marrëveshja e grantit (GEF TFGA) të jetë disbursuar plotësisht dhe palët e kësaj Marrëveshjeje të kenë përmbushur detyrimet e tyre.

Seksioni 6.03 Data nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje është specifikuar për qëllimet e seksionit 12.04 të kushteve të përgjithshme.

Neni 7  
**Përfaqësuesit e Marrësit, adresat**

Seksioni 7.01 Ministri i Financave i Marrësit është caktuar si përfaqësues i Marrësit për qëllimet e seksionit 11.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat që vijojnë janë specifikuar për qëllimet e seksionit 11.01 të kushteve të përgjithshme:

Për Marrësin:  
Ministria e Financave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”  
Tiranë, Shqipëri  
Faks 3554228494

Për Bankën:  
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim  
1818. H.Street, NV  
Washington DC 20423, SHBA

|                          |             |               |
|--------------------------|-------------|---------------|
| Adresa kablllore         | Telex       | Fax           |
| INTAFRAD                 | 248423(MCI) | (202)477-6391 |
| Washington DC64145 (MCI) |             |               |

Në dëshmi të sa më sipër, palët këtu, duke vepruar përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar posaçërisht, kanë firmosur këtë Marrëveshje me emrat e tyre respektivë në \_\_\_\_\_, në datën dhe vitin të shkruar më sipër.

SKEDULI I  
**TËRHEQJET E PËRFITIMIT PREJ GRANTIT (GEF TFG)**

1. Tabela më poshtë përshkruan kategoritë e zërave që do të financohen nga shuma e grantit (GEF TFG), shpërndarja e sasisë së grantit (GEF TFG) në këto kategori dhe përqindja e shpenzimeve për zërat që do të financohen në këtë kategori:

| Kategoritë e kredisë   | Shuma e caktuar e shprehur në USD ekuivalent | % e shpenzimeve që do të financohen |
|------------------------|----------------------------------------------|-------------------------------------|
| 1. Mallra              | 615 000                                      | 89%                                 |
| 2. Punime              | 3 740 000                                    | 89%                                 |
| 3. Shërbime konsulence | 120 000                                      | 89%                                 |
| 4. Plane menaxhimi     | 345 000                                      | 89%                                 |

|                    |           |     |
|--------------------|-----------|-----|
| 5. Trajnime        | 40 000    | 89% |
| 6. Kosto operative | 140 000   | 89% |
| TOTALI             | 5 000 000 | 89% |

2. Për qëllimet e këtij skeduli:

a) Termi “Trajnime” nënkupton shpenzimet e Huamarrësit në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve të trajnimeve, turet studimore dhe seminareve në projekt, duke përfshirë koston e udhëtimit, dietat për trajnuesit lokalë, të trajnuarit dhe pjesëmarrësve në seminare, qiranë për lehtësirat dhe pajisjet, materialet e trajnimit, si dhe mjetet e nevojshme.

b) Termi “Kosto operative” kupton shpenzimet e arsyeshme dhe të domosdoshme, siç janë miratuar nga Shoqata, në bazë të buxheteve të pranueshme nga Shoqata, që nuk kanë ndodhur në mungesë të projektit dhe përfshijnë ndër të tjera, kostot për sa i përket: (i) mirëmbajtjes dhe përdorimit të pajisjeve të zyrave dhe makinave të prokuruar ose të përdorura për menaxhimin e projektit; (ii) rrogat e paguara për stafin, me përjashtim të pagave të nëpunësve civilë, të kontraktuar për qëllimet e projektit; (iii) kostot e udhëtimit dhe dietat që i paguhen stafit që është kontraktuar për qëllimet e projektit; dhe (iv) materiale zyre dhe shërbimet e domosdoshme.

c) Termi “Shërbim i ndërtimit të kapaciteteve” nënkupton shpenzimet, kostot e shërbimeve për zhvillimin e kapaciteteve dhe realizimin e programeve për ndërtimin e kapaciteteve për qeverinë dhe organizatat e shoqërisë civile përgjegjëse direkte për menaxhimin e burimeve natyrore shoqëruar me zbatimin e aktiviteteve të projektit.

d) Termi “Planifikim i menaxhimit” nënkupton shpenzimet për kostot për përgatitjet dhe përditësimin e planeve të menaxhimit për pyjet dhe kullotat komunale dhe përgatitjen e planeve të menaxhimit e burimeve në mikrobases e (MB) duke përfshirë dietat dhe shpenzimet e udhëtimit për stafin e DSHP, si dhe stafit rajonal të mikrobaseseve, kur janë të shoqëruara direkt me aktivitete të zbatimit të projektit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 më sipër, nuk do të bëhen tërheqje për pagesat që janë bërë përpara datës së kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të tërheqjeve, në një sasi që nuk e kalojnë sasinë në total pesëdhjetë mijë dollarë (50 000) që mund të jenë bërë në lidhje me kategoritë e lejueshme në llogaritë e pagesave të bëra për shpenzime përpara kësaj date, por pas 1 marsit 2005.

4. Banka mund të kërkojë që tërheqjet nga llogaria e grantit (GEF GA) të bëhen në bazë të raporteve të shpenzimeve për kontratat për: (a) mallra që kushtojnë më pak se 100 000 dollarë për kontratë; (b) punime që kushtojnë më pak se 100 000 dollarë për kontratë; (c) shërbime të konsulentëve individualë me kontrata që kushtojnë më pak se 50 000 dollarë për kontratë; (d) shërbime të firmave konsulente me kontrata që kushtojnë më pak se 100 000 dollarë për kontratë; dhe (e) të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet e konsulentëve me kontrata midis komunave dhe SHPPK, sipas termave dhe kushteve që Banka do të specifikojë dhe njoftojë Marrësin.

5. Me të marrë njoftim me shkrim nga Banka, Marrësi mund të kërkojë tërheqje nga llogaria e grantit (GEF TFGA), që do të bëhet në bazë të raporteve të dërguara Bankës në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, të cilat do të përfshihen në raportin e monitorimit financiar (GEF-FMR) dhe në ndonjë informacion tjetër që Banka do të specifikojë me shkrim Marrësin (disbursime të bazuara në raporte). Në rastin kur një kërkesë e tillë i dërgohet Bankës përpara se të ketë bërë ndonjë tërheqje nga llogaria e grantit të (GEF TFGA), Marrësi do të dërgojë në Bankë një raport me burimet e parashikuara, si dhe aplikimet për fonde për një periudhë 6 mujore pas datës së kësaj kërkesë.

B. Llogaria speciale e grantit (GEF)

1. Marrësi mund të hapë dhe mbajë në dollarë një llogari speciale në një bankë të pranueshme nga Banka me terma dhe kondita të kënaqshme për Bankën, duke përfshirë edhe mbrojtjen e duhur nga luhatjet e konfiskimi.

2. Mbasi Banka të ketë njoftime të kënaqshme se llogaria speciale e grantit (GEF SA) është hapur, tërheqjet nga llogaria e grantit (GEF FGA) të shumave që do të depozitohen në Llogarinë speciale të grantit (GEF) duhet të bëhen si më poshtë:

a) Nëse Marrësi nuk bën disbursime të bazuara në raporte, tërheqjet do të bëhen sipas parashikimeve në aneksin A të këtij skeduli 1;

b) Nëse Marrësi ka bërë disbursime të bazuara në raporte, tërheqjet do të bëhen sipas parashikimeve në aneksin B të skedulit 1.

3. Pagesat nga llogaria speciale e (GEF) do të bëhen vetëm për shpenzime të lejueshme. Për

çdo pagesë që Marrësi do të bëjë nga llogaria speciale e grantit (GEF SA), Marrësi do t'i paraqesë Bankës dokumente të tilla ose evidenca që do të tregojnë që pagesat janë bërë për shpenzime të ligjshme në atë kohë që Banka do ta quajë të arsyeshme t'i kërkojë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit 2 të pjesës B të këtij skeduli, Bankës nuk do t'i kërkohej të bëjë depozitime të mëtejshme në llogarinë speciale të grantit (GEF SA):

a) Nëse Banka në çdo kohë, nuk është e kënaqur që raportet sipas paragrafit 5 të pjesës A të këtij skeduli 1 nuk sigurojnë siç duhet informacionin e kërkuar në disbursimet e bazuara në raporte;

b) Nëse në çdo kohë Banka vendos që të gjitha tërheqjet e mëtejshme të pagesave për shpenzime të lejuara duhet të bëhen nga Marrësi direkt nga llogaria e grantit (GEF TFGA); ose

c) Nëse Marrësi nuk i ka paraqitur Bankës, brenda një periudhe të caktuar në seksionin 4.01 (b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, ndonjë prej raporteve të auditimit të kërkuar prej Bankës, sipas asaj që thuhet në seksion për auditimin e: (A) të regjistrimeve dhe shumave në llogarinë speciale të grantit (GEF SA); ose (B) regjistrimeve dhe llogarive sipas të cilave tërheqjet janë bërë si disbursime të bazuara në raporte ose janë bërë në bazë të raportit të shpenzimeve, ashtu siç mund të jetë rasti.

5. Bankës nuk do t'i kërkohej të bëjë depozitime të mëtejshme në llogarinë speciale të (GEF SA) në përputhje me kushtet e paragrafit 2 të pjesës B të këtij skeduli, në qoftë se ndonjëherë Banka do të ketë njoftuar Marrësin për qëllimin e saj për të pezulluar në tërësi ose pjesërisht të drejtën e Marrësit të bëjë tërheqje nga llogaria e grantit të (GEF SA) në vijim të seksionit 6.02 të kushteve të përgjithshme. Pas një njoftimi të tillë, Banka do të përcaktojë, me zgjedhjen e saj, nëse depozita të mëtejshme në llogarinë speciale të grantit (GEF SA) mund të bëhen dhe çfarë procedurash mund të ndiqen për bërjen e të tilla depozitave dhe do të njoftojë Marrësin për vendimin e saj.

6.a) Në qoftë se Banka vendos në çdo kohë që ndonjë pagesë e bërë nga llogaria speciale e grantit (GEF SA), për shpenzime të cilat nuk janë shpenzime të lejuara, ose nuk ishin justifikuar nga ndonjë evidencë të dërguar Bankës, Marrësi menjëherë, pasi të jetë njoftuar nga Banka, duhet t'i sigurojë menjëherë të tilla evidenca shtesë ashtu si Banka mund të kërkojë, apo të depozitojë në llogarinë speciale të grantit (GEF SA), (ose në qoftë se Banka do të kërkojë, për kthimin e fondit Bankës) një sasi të barabartë me një pagesë të tillë të bërë. Përdërisa Banka nuk do të jetë dakord ndryshe, nuk do të bëhen depozita të tjera nga Banka në llogarinë speciale të grantit (GEF SA) derisa marrësi të ketë siguruar një evidencë të tillë ose të ketë bërë depozitime apo kthim të parave, ashtu si mund të jetë rasti.

b) Në qoftë se Banka vendos në çdo kohë që ndonjë sasi në llogarinë speciale të grantit (GEF-SA) nuk do të kërkohej për të mbuluar pagesa për shpenzime të lejueshme për gjatë gjashtë muajve pas një vendimi të tillë, Marrësi menjëherë, pasi të jetë njoftuar nga Banka, do t'ia kthejë Bankës këtë sasi të papërdorur.

c) Marrësi mundet, që pasi të ketë njoftuar Bankën, t'i transferojë Bankës të gjitha apo ndonjë pjesë të fondeve të depozitës në llogarinë speciale të grantit (GEF SA).

d) Kthimi i shumave Bankës të bëra sipas nënparagrafit (a), (b) ose (c) të këtij paragrafi 6, do të kreditohen te llogaria e grantit (GEF TFGA) për tërheqjen e mëpasme apo anulimin në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

#### ANEKS A I SKEDULIT 1 VEPRIMET ME LLOGARINË SPECIALE TË GRANTIT (GEF SA) KUR TËRHEQJET NUK JANË DISBURSIME TË BAZUAR NË RAPORTE

1. Sipas këtij aneksi, me termin "Autorizim për tërheqje" nënkuptojmë shumën USD 500 000 që do të tërhiqet nga llogaria e grantit (GEF TFGA) dhe depozitohen në llogarinë speciale të grantit (GEF SA) sipas paragrafit 2 të këtij aneksi.

2. Tërheqja e shumës së autorizuar dhe tërheqjet e njëpasnjëshme për mbushjen e Llogarisë Speciale të (GEF SA) do të bëhen si më poshtë:

a) Për tërheqjen e shumës së autorizuar, Marrësi do t'i paraqesë Bankës një kërkesë ose kërkesat për depozitën fillestare në llogarinë speciale në një shumë jo më të madhe se shuma e autorizuar për tërheqje. Në bazë të çdo kërkesë për tërheqje, Banka në emër të Marrësit, do të tërheqë

nga Llogaria e Grantit (GEF TFGA) dhe depozitohet në Llogarinë Speciale të Grantit shumë sipas kërkesës së Marrësit.

b) Për rimbushjen e Llogarisë Speciale të Grantit (GEF SA), Huamarrësi duhet t'i paraqesë Bankës kërkesat për rimbushje të llogarisë sipas periudhave të specifikuara. Përpara apo në të njëjtën kohë me një kërkesë të tillë, Huamarrësi duhet t'i paraqesë Bankës dokumentet ose evidencat e kërkuara sipas pjesës B 3 të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje për pagesën ose pagesat në përputhje me çdo kërkesë për rimbushje. Në bazë të secilës nga kërkesat, Banka në emër të Marrësit, tërheq nga Llogaria e Grantit të (GEF TFGA) dhe depoziton në Llogarinë Speciale të Grantit ato shuma siç Marrësi i ka kërkuar dhe treguar me anë të dokumenteve dhe evidencave për shpenzime të lejuara. Çdo depozitim i shumave në Llogarinë Speciale të Grantit do të tërhiqet nga Banka nga Llogaria e Grantit (GEF-TFGA) sipas një ose më shumë kategorive të lejuara të disbursimit.

3. Banka nuk duhet të kërkojë mbushje të mëtejshme të Llogarisë Speciale të Grantit (GEF SA), kur në total shumat e patërhequra të grantit, minus shumë totale të fondeve të përdorura të hyra nga Banka, sipas seksionit 5.02 të kushteve të përgjithshme, do të tregojnë një shumë të njëjtë me dyfishin e autorizimit për tërheqje. Më pas, tërheqjet nga shumat e mbetura të patërhequra duhet të ndjekin procedurat të specifikuara nga Banka me njoftimin e Marrësit.

Tërheqjet e mëtejshme do të bëhen vetëm pas dhe deri në nivelin që Banka të jetë e kënaqur që sasia e mbetur në depozitën e Llogarisë së Grantit deri në datën e këtij njoftimi do të jetë përdorur vetëm për pagesa të shpenzimeve të lejuara.

#### ANEKSI B I SKEDULIT 1 VEPRIMI ME LLOGARINË SPECIALE KUR TËRHEQJET BAZOHEN NË DISBURSIME TË BAZUARA NË RAPORTE

1. Tërheqjet nga Llogaria e Grantit të (GEF TFGA) do të depozitohen nga Banka në Llogarinë Speciale të Grantit në përputhje me kushtet e skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje. Çdo depozitim në Llogarinë Speciale do të tërhiqet nga Banka nga Llogaria e Grantit sipas kategorive të lejuara.

2. Pas marrjes së çdo aplikimi për tërheqjen e shumave nga Granti (GEF TFG), Banka në emër të Marrësit do të tërheqë nga Llogaria e Grantit dhe depozitohet në Llogarinë Speciale të Grantit një shumë të barabartë ose më pak se: (a) të shumës së kërkuar dhe (b) shuma të cilën Banka ka vendosur, bazuar në raportet sipas pjesës A5 të skedulit 1 të aplikueshëm për të tilla kërkesa për tërheqje, është kërkuar të depozitohen me qëllim që të financojë shpenzimet e lejuara gjatë periudhës 6-mujore që vijojnë pas datës së të tilla raporteve financiare.

#### SKEDULI 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është që të vendosë menaxhimin e qëndrueshëm me bazë komuniteti të burimeve natyrore në rreth 218 komuna të zonave të larta malore objekt erozioni.

Projekti përbëhet nga pjesët që vijojnë, subjekt i të tilla modifikimeve që këtej e tutje Marrësi dhe Banka mund të bien dakord kohë pas kohe për të arritur këtë objektiv:

Pjesa A: Menaxhimi dhe qeverisja e pyjeve dhe kullotave

1. Forcimi i menaxhimit pjesëmarrës të pyjeve dhe kullotave në komunat e mbështetura nga AFP nëpërmjet:

a) përditësimit të planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave komunale të përgatitura gjatë PSHP;

b) zbatimit të planeve të përditësuara të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave të hartuara gjatë AFP. Projekti do të afrojë mbështetje për zbatimin e planit të menaxhimit përmes investimeve të vogla, dhe

c) mbështetjes së ripërtëritjes natyrore për të sekuestruar karbonin me qëllim kapjen e burimeve financiare të karbonit, nëpërmjet financimit të investimeve të vogla në rreth 30 komuna.

2. Aplikimi i menaxhimit pjesëmarrës të pyjeve dhe kullotave në rreth 73 komuna të reja

nëpërmjet:

- a) përgatitjes së planeve të menaxhimit për pyjet dhe kullotat komunale;
  - b) zbatimit të planeve të menaxhimit për pyjet dhe kullotat komunale.
3. Forcimi i qeverisjes për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave nëpërmjet:
- a) ndërtimit e kapacitetit të shoqatave ekzistuese dhe të reja të përdorimit të pyjeve dhe kullotave (SHPPK), nëpërmjet vlerësimit të kapaciteteve dhe nevojave për trajnim të SHPPK dhe zbatimin e një skeduli të gjërë për të forcuar kompetencat menaxhuese e qeverisëse të SHPPK;
  - b) trajnimit të stafit kyç të DPPK në nivel kombëtar dhe në drejtoritë rajonale të DPPK, dhe stafin kyç të DSHP që të bëhen këshilltarë për ekstensionin në pyje dhe kullota;
  - c) zbatimi e veprimeve prioritare të parashikuara në strategjinë kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave duke përfshirë: (i) mbështetjen e reformës institucionale dhe zhvillimit brenda DPPK dhe DSHP-ve; (ii) sensibilizimin për strategjinë kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave brenda DPPK dhe DSHP-ve; (iii) forcimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave; (iv) zhvillimin e regjistrave për pyjet dhe kullotat; (v) zhvillimin dhe zbatimin e një plani veprimesh për të adresuar prerjet ilegale në zonat e projektit; dhe (vi) menaxhimin e përmirësuar të zjarreve në pyje në nivel komune.

Pjesa B: Menaxhimi dhe qeverisja e baseneve

1. Aplikimi i menaxhimit të integruar të resurseve në rreth 30 mikrobasene që përfshijnë një territor prej rreth 190 000 ha, nëpërmjet:

- a) Përgatitjes së rreth 30 planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave dhe planeve të menaxhimit të burimeve në mikrobasene (MB);
- b) Zbatimit të këtyre planeve të pyjeve dhe kullotave komunale dhe planit të menaxhimit të burimeve natyrore të mikrobaseneve (MB) nëpërmjet financimit të investimeve në shkallë të vogël dhe sigurimit të mbështetjes teknike përveç të tjerash, menaxhimit të pyjeve dhe kullotave komunale, rehabilitimit të pyjeve shtetërore, si dhe zhvillimeve në bujqësi dhe blegtori.

2. Forcimi i qeverisjes për menaxhimin e basenit nëpërmjet: a) trajnimit të drejtorive bujqësore rajonale, bordeve të kullimit, stafin e DSHP-ve dhe komunave në nivel rrethi, rajonal dhe kombëtar në trajtën e shërbimit këshillimor në kontekstin e menaxhimit të mikrobaseneve; b) forcimit të zyrave të mbrojtjes dhe administrimit të tokës (ZMAT); c) të sigurojë këshilla juridike si dhe seminare për konsultime publike në ligjet në lidhje me administrimin dhe pronësinë mbi tokën.

Pjesa C: Menaxhimi dhe monitorimi i projektit

1. Ngritja e ndërgjegjësimit publik të përfituesit dhe pjesëmarrësit e tjerë në nivel kombëtar, rajonal dhe komunë, për nevojën dhe mundësitë që krijohen nga menaxhimi i resurseve të bazuar në komunitet, si dhe çështjeve të lidhura me të, si menaxhimi i zjarreve dhe kontrolli i prerjeve ilegale.

2. Menaxhimi, monitorimi dhe vlerësimi i projektit.

3. Verifikimi dhe monitorimi i sekuestrimit të karbonit, siç kërkohet nga protokollin e Kiotos.

Projekti pritet që të kompletohet brenda 1 majit 2010.

### SKEDULI 3 PROKURIMET

#### Seksioni I Të përgjithshme

A. Të gjitha mallrat dhe punimet do të prokurohen në përputhje me “Udhëzuesit”: Prokurimet për huatë e IBRD-së dhe për kreditë e IDA-s” të botuara nga Banka në maj 2004 (Udhëzuesit e prokurimeve) dhe në përputhje me kushtet e këtij skeduli 3.

B. Të gjitha shërbimet e konsulentëve do të prokurohen në përputhje me seksionin I dhe IV të “Udhëzuesit: Seleksionimin dhe punësimin e konsulentëve nga huamarrësit Banka Botërore” botuar në maj 2004 (Udhëzuesit i konsulentëve) dhe në përputhje me këtë program.

C. Termat kapitale të përdorur më poshtë në këtë program për të përshkruar në metoda të veçanta prokurimit ose metodat e rishikuara nga Banka për kontrata të veçanta, kanë kuptimin e përshkruar në udhëzuesit e prokurimeve ose udhëzuesit e konsulentëve, në çdo rast që mund të paraqitet.

#### Seksioni II Metodatat për prokurimin e mallrave dhe punimeve

A. Tendera të hapur ndërkombëtarë. Përveç rasteve kur paraqitet ndryshe në pjesën B të këtij seksioni, kontratat do të përcaktohen në bazë të tenderit të hapur ndërkombëtar. Kushtet e paragrafëve

2.55 dhe 2.56 të udhëzuesve të prokurimeve, që sigurojnë preferenca për prodhimet e vendit në vlerësimin e ofertave, do të aplikohen për mallrat e prodhuara brenda territorit të Marrësit.

**B. Procedura të tjera prokurimi**

1. Blerjet. Mallrat dhe punimet që vlerësohen deri në 100 000 dollarë për kontratë mund të prokurohen me metodën e blerjeve.

2. Kontraktim direkt. Mallrat dhe punimet që përmbushin kërkesat e kontraktimit direkt për të cilat Banka bie dakord, mund të prokurohen në përputhje me kushtet e kësaj metode prokurimi.

**Seksioni III Metoda të veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulencës**

A. Zgjedhje bazuar në cilësinë dhe koston. Me përjashtim të rasteve të paparashikuara ndryshe në pjesën B të këtij seksioni, shërbimet e konsulencës do të prokurohen mbi bazën e zgjedhjes së cilësisë dhe koston. Sipas parashikimit të paragrafit 2.7 të udhëzuesve të konsulencës, lista e shkurtër e konsulentëve, e vlerësuar me deri në 100 000 dollarë për kontratë, mund të përbëhet tërësisht me konsulentë lokalë.

**B. Procedura të tjera**

1. Zgjedhje me buxhet fiks. Shërbimet për të cilat Banka bie dakord që përmbushin kërkesat e paragrafit 3.5 të udhëzuesit të konsulentëve mund të prokurohen me metodën me buxhet fiks në përputhje me kushtet e paragrafëve 3.1 dhe 3.5 të udhëzuesit të konsulentëve.

2. Zgjedhje sipas kualifikimit të konsulentëve. Shërbimet e konsulentëve të vlerësuara deri në 200 000 dollarë për kontratë mund të prokurohen në përputhje me kërkesat e paragrafëve 3.1, 3.7 dhe 3.8 të udhëzuesit të konsulentëve.

3. Zgjedhje me një burim të vetëm. Shërbimet për detyra në rrethanat që plotësojnë kushtet e paragrafit 3.10 të udhëzuesit të konsulentëve me zgjedhje njëburimore, mundet me rënie paraprake dakord të Bankës, të prokurohen sipas paragrafëve 3.9 dhe 3.10 të udhëzuesit të konsulentëve.

4. Konsulentët individualë. Shërbimet e konsulentëve që janë në përputhje me paragrafin 5.1 të udhëzuesve të konsulentëve mund të prokurohen për shërbime konsulence individuale në përputhje me paragrafët 5.2 dhe 5.3 të udhëzuesve të konsulentëve. Në rrethanat e përshkruara në paragrafin 5.4 të udhëzuesve të konsulentëve, këto kontrata mund të kontraktohen mbi bazën e një burimi të vetëm.

5. Pjesëmarrja e komunitetit. Shërbimet e kërkuara nga pjesa A.2 (a) dhe pjesa B 1(a) të projektit që vlerësohet deri në 10 000 dollarë për kontratë mund të kontraktohen mbi bazën e pjesëmarrjes së komunitetit në përputhje me procedurat e parashikuara në planin e prokurimeve dhe në manualin e zbatimit të projektit.

**Seksioni IV Rishikimi nga Banka e vendimeve të prokurimit**

Me përjashtim kur Banka do të vendosë ndryshe dhe do të njoftojë Marrësin, kontratat e mëposhtme do të jenë subjekt i kontrollit paraprak nga Banka: (a) çdo kontratë për mallra dhe punimet e vlerësuar me një shumë të barabartë ose më shumë se 100 000 dollarë do të prokurohet me metodën e tenderit të hapur ndërkombëtar; (b) kontratat e shërbimit të konsulencës e barabartë ose më shumë se 100 000 dollarë; (c) të gjitha kontratat e shërbimit të konsulencës të prokuruar në bazën e zgjedhjes nga një burim i vetëm zgjedhje; dhe (d) të gjitha kontratat për mallra dhe punimet të prokuruar me metodën e kontraktimit direkt, përveç kontratave midis komunave dhe shoqatave të përdorimit të pyjeve dhe kullotave. Të gjitha kontratat e tjera do të jenë objekt i rishikimit të mëvonshëm nga Banka.

**SKEDULI 4  
PROGRAMI I ZBATIMIT**

1. Huamarrësi do të zbatojë projektin sipas mekanizmave të mëposhtëm të koordinuar:

a) Në nivel kombëtar:

i) Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, nëpërmjet DPPK, do të jetë përgjegjëse për zbatimin e projektit. Një Komitet Teknik i Projektit (PTC) i vendosur në MBU, do të ofrojë mbikëqyrje teknike dhe udhëzime teknike për zbatimin e projektit. Komitetit do të kryesohet nga drejtori i zyrës së Programeve Bujqësore brenda MBU-së dhe do të ketë pjesëmarrjen e drejtorit të Përgjithshëm të DPPK, dhe të disa seksioneve të MBU-së: Zyrën e Programeve Bujqësore, Drejtorinë e Zhvillimit Rural, Drejtorinë e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës dhe departamenti i ligjeve dhe financës. Gjithashtu do të ketë përfaqësues të Federatës Kombëtare të Shoqatave të Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunale, Sekretariati Kombëtar për Menaxhimin e Bazeneve Ujëmbledhëse në Ministrinë

e Turizmit dhe organizatat joqeveritare.

ii) Njësia e projektit do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e projektit, duke përfshirë përgatitjen e zbatimit e planeve të punës, prokurimet, menaxhimin financiar, raportimin dhe monitorim vlerësimin e projektit. Në njësinë e projektit do të përfshihet stafi i emëruar në DPPK dhe menaxheri i kontraktuar. Drejtori i Pyjeve dhe Kullotave Komunale dhe Shërbimit të Ekstensionit do të caktohet si koordinator i projektit. Njësia e projektit do të mbështetet nga një staf i kontraktuar prej pesë vetash, si dhe një staf i emëruar për monitorimin e vlerësimin e projektit, ashtu siç përshkruhet në detaje në manualin e zbatimit të projektit.

iii) Komiteti Mbikëqyrës i Projektit do të sigurojë koordinimin ndërministerial dhe do të mbikëqyrë projektin.

b) Në nivel rajonal:

i) Për mbikëqyrjen e përgjithshme dhe zbatimin e projektit, menaxherët rajonalë do të emërohen nga DSHP në secilin nga 12 rajonet administrative të Marrësit.

ii) Për mbikëqyrjen rajonale dhe zbatimin e pjesës B të projektit, koordinatorët rajonalë do të kontraktohen për zyrat e DSHP-ve në rrethet Dibër, Kukës, Lezhë, Korçë dhe Drejtoria Rajonale e Pyjeve Elbasan do të asistojë menaxherët rajonalë. Njësitë mbështetëse rajonale të baseneve (RVST), do të krijohen dhe mirëmbahen në Dibër, Kukës, Lezhë, Elbasan e Korçë për të lehtësuar dhe koordinuar planifikimin dhe zbatimin në mikrobasene. RVST do të përfshijnë menaxherët rajonalë, koordinatorët rajonalë dhe staf i emëruar prej DSHP-ve dhe Drejtorive Rajonale të Bujqësisë.

c) Në nivel komune, këshilli i komunës dhe shoqatat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave janë përgjegjëse për zbatimin e projektit.

2. Marrësi duhet të sigurojë që gjatë gjithë jetës së projekti, Komiteti Mbikëqyrës i Projektit, Komiteti Teknik i projektit, Njësia e Menaxhimit të Projektit, Njësitë Mbështetëse Rajonale të Baseneve do të jenë operative, të pajisura me stafin e duhur dhe do të funksionojnë sipas termave të referencës të pranueshëm nga Banka.

3. Marrësi:

a) do të ndjekë politika dhe procedura të përshtatshme për të bërë të mundur monitorimin dhe vlerësimin në vazhdimësi në përputhje me indikatorë të pëlqyeshëm për shoqatën, për zbatimin e projektit dhe realizimin e objektivave të tij;

b) do të përgatisë sipas termave të referencës të pëlqyeshëm për Bankën dhe t'ia paraqesë Bankës, në ose rreth 1 majit 2008, një raport që integron rezultatet e aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit të bëra në përputhje me paragrafin (a) të këtij seksioni për progresin e arritur në zbatimin e projektit gjatë një periudhe që ka operuar deri në ditën e raportimit dhe masat e rekomanduara për të siguruar zbatimin me efikasitet të projektit dhe për arritjen e objektivave gjatë periudhës pas kësaj date; dhe

c) do të rishikojë me Bankën nga data 30 korrik 2008 ose në një datë të mëvonshme, siç mund ta kërkojë Banka, raportin e përmendur në paragrafin (b) të këtij seksioni dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përfundimin efikas të projektit dhe arritjen e objektivave të tij, bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e raportit dhe pikëpamjet e Bankës mbi të.

4. Marrësi përgatit dhe i paraqet Bankës, jo më vonë se data 30 shtator të çdo viti, për rishikim dhe komente, buxhetin për DPPK-në dhe MBU-në për çdo vit kalendarik.

5. Marrësi duhet të marrë të gjitha masat e domosdoshme që të garantojë se projekti do të zbatohet në përputhje të plotë me parashikimin e Kuadrit të Menaxhimit Mjedisor dhe Manualin e zbatimit të projektit në afate kohore.

## **L I G J**

**Nr.9438, datë 27.10.2005**

### **PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES USHTARAKE GRANT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ushtarake grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4694, datë 11.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJE USHTARAKE GRANT**  
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË  
SË REPUBLIKËS TË TURQISË

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë, duke riafirmuar dhe një herë marrëdhëniet e tyre të gjata miqësore,

*duke iu referuar* Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e trajnimit ushtarak, teknikës dhe shkencës datë 29.7.1992 dhe Marrëveshjes së bashkëpunimit dhe trajtimit ushtarak të datës 19.11.1992,

*me qëllim* forcimin e bashkëpunimit ushtarak dhe kontributit për ristrukturimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qeveria e Republikës së Turqisë do t’i dhurojë 1 320 000 (një milion e treqind e njëzet mijë) lira turke të reja, ekuivalente në dollarë amerikanë, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Granti do të jetë i disponueshëm nga viti 2005.

Neni 2

Granti prej 1 320 000 (një milion e treqind e njëzet mijë) lira turke të reja, ekuivalente në dollarë amerikanë, do të sigurohet si materiale dhe shërbime, në përputhje me rregullat në fuqi të Republikës së Turqisë.

Neni 3

Granti prej 1 320 000 (një milion e treqind e njëzet mijë) lira turke të reja, ekuivalente në dollarë amerikanë, do të realizohet në përputhje me protokollin e zbatimit logjistik, i cili do të nënshkruhet ndërmjet zyrtarëve të të dyja palëve të referuara në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Republika e Shqipërisë bie dakord të mos ia transferojë titujt, materialet, shërbimet një vendi ose pale tjetër, pa marrë më parë miratimin e Republikës së Turqisë, e cila ka dhënë këtë grant.

Neni 5

Marrëveshja do të hyjë në fuqi datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nga palët, lidhur me përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme për ratifikim, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, dhe do të jetë në fuqi deri sa të gjitha materialet e shërbimet të specifikuar në protokollin zbatues t'i jenë dhënë Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës të Shqipërisë.

Marrëveshja grant do të zbatohet nga Ministria e Mbrojtjes në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe nga Shtabi i Përgjithshëm turk në emër të Republikës turke.

Çdo marrëveshje e lindur gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me diskutime dhe bisedime dypalëshe.

Kjo Marrëveshje është përgatitur në shqip, turqisht e anglisht. Në rast të mosmarrëveshjeve, lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, teksti anglisht i marrëveshjes do të jetë prioritar.

Kjo marrëveshje është nënshkruar në Tiranë, më 5 shtator 2005.

Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së  
Shqipërisë  
LUAN HOXHA  
Gjeneral Major  
Zëvendësues i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të  
Armatosura

Në emër të Qeverisë së Republikës të Turqisë  
ALI AKDOGAN  
Gjeneral Brigade  
Shef i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve dhe  
Planifikimit të Mbrojtjes në Shtabin e Përgjithshëm

#### Rezolutë

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duke ndjekur me vëmendje të veçantë fazën përmbyllëse të përgatitjeve për diskutimin e statusit të Kosovës,

- **duke përshëndetur** vendimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për fillimin e bisedimeve për përcaktimin e statusit të Kosovës;

- **duke vërejtur** progresin e dukshën në krijimin e bazave të një shoqërie të hapur dhe të konsolidimit të shtetit ligjor në Kosovë, pasqyruar edhe në raportin "Aide";

- **duke vlerësuar** përpjekjet e institucioneve të Kosovës, Presidentit, Kuvendit, Qeverisë, partive politike dhe banorëve të Kosovës në ndërtimin e një Kosove demokratike e multietnike;

- **duke falënderuar** bashkësinë ndërkombëtare dhe në veçanti NATO-n, për angazhimin në përballimin e krizës kosovare, si dhe UNMIK-un, KFOR-in dhe OSBE-në për kontributin në stabilizimin gradual të situatës në vend, si dhe në ndërtimin e institucioneve;

- **duke shprehur** bindjen se roli i bashkësisë ndërkombëtare do të vazhdojë të mbetet esencial edhe në të ardhmen për një Kosovë të integruar në strukturat europiane dhe auroatlantike;

- **duke nënvizuar** nevojën e kalimit nga statusi aktual në krijimin e një shteti të ngritur mbi parimet ndërkombëtare të paqes sociale, sundimit të ligjit e bashkëjetesës multietnike;

- **duke vlerësuar** rolin shumëplanësh të Shqipërisë qysh në përballimin e krizës politike, humanitare në Kosovë, si dhe në sigurimin e vazhdueshëm të paqes dhe stabilitetit në rajon;

- **duke inkurajuar** e mbështetur nisma e projekte konkrete të Qeverisë, që do të ndihmonin zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të Kosovës, si dhe do të intensifikonin dialogun dypalësh e shumëpalësh në rajon;

- **duke mbështetur** vullnetin e lirë të popullit të Kosovës, i cili tashmë është shprehur për pavarësi;

- **duke vlerësuar** rëndësinë që kanë qëndrimet e shtetit shqiptar për zhvillimet në Kosovë;

- **mbetet i angazhuar** në veprimin e tij politik diplomatik gjatë gjithë periudhës së negociatave për përcaktimin e statusit të Kosovës;

- **shpreson fuqishëm** se nga procesi i bisedimeve do të dalë një rezultat i qëndrueshëm, i cili reflekton aspiratat dhe vullnetin e lirë të qytetarëve të Kosovës për një shtet të pavarur, demokratik, europian;

- **u kërkon** institucioneve shtetërore dhe fton organizatat e shoqërisë civile dhe mediat të

dëshmojnë kohezion dhe përgjegjësi gjatë këtyre zhvillimeve.

Tiranë, më 21 nëntor 2005

**DEKRET**  
**Nr.4703, datë 24.11.2005**

**PËR FALJE DËNIMI**

Në mbështetje të neneve 92 pika b, 93 dhe 94 të Kushtetutës, me propozim të organeve të pushtetit lokal, në kuadrin e festave të nëntorit,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

1. Lenin Preng Rajta, dënuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.469, datë 16.10.2002, i falet dënimi i mbetur.
2. Taulant Nazif Preçi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Elbasan, me vendimin nr.159, datë 20.6.2003, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.
3. Valentin Bardhok Gjokeja, dënuar me vendimin nr.80, datë 13.2.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndryshuar me vendimin nr.593, datë 17.11.2004 të Gjykatës së Lartë, i falen 3 vjet nga dënimi i mbetur.
4. Marin Frrok (Ndreca) Jaku, dënuar nga Gjykata e Rrethit Mirditë, vendimin nr.68, datë 12.12.2001, i falet dënimi i mbetur.
5. Klodian Hajri Qoku, dënuar nga Gjykata e Rrethit Dibër, me vendimin nr.40, datë 7.6.2001, i falet dënimi i mbetur.
6. Kastriot Nikoll Plaku, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.491, datë 7.5.2004, i falet dënimi i mbetur.
7. Tom Gjon Zefi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Lezhë, me vendimin nr.58, datë 21.3.2001, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.
8. Pal Pjetër Prenga, dënuar nga Gjykata e Rrethit Mirditë, me vendimin nr.20, datë 17.2.2004, i falet dënimi i mbetur.
9. Irakli Jakov Çakalli, dënuar nga Gjykata e Rrethit Elbasan, me vendimin nr.70, datë 3.7.2000, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.
10. Sherif Abedin Kasma, dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjirokastrë, me vendimet nr.94, datë 21.12.2000 dhe nr.4, datë 20.1.2003, bashkuar dënimet me vendimin nr.114, datë 15.10.2004 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, i falet dënimi i mbetur.
11. Bledar Kastriot Zanaj, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.895, datë 17.10.2003, i falet dënimi i mbetur.
12. Bledar Tafil Gjolena, dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.1, datë 10.3.2004, i falet dënimi i mbetur.
13. Fatmir Hetem Oruçi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Sarandë, me vendimin nr.41, datë 5.6.2003, i falet dënimi i mbetur.
14. Kastriot Gjergj Haxhia, dënuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.570, datë 21.12.2000, i falen 6 muaj nga dënimi i mbetur.
15. Lavdosh Nazif Serjani, dënuar nga Gjykata e Rrethit Kolonjë, me vendimin nr.1, datë 15.1.1997, i falet dënimi i mbetur.
16. Lodovik Fran Lumaj, dënuar me vendimin nr.306, datë 17.12.2002 të Gjykatës së Rrethit

Shkodër, ndryshuar me vendimin nr.8, datë 20.1.2004 të Gjykatës së Apelit Shkodër, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

17. Ylli Rrapi Meço, dënuar nga Gjykata e Rrethit Elbasan, me vendimin nr.94, datë 19.7.1999, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

18. Vladimir Sabri Kadiu, dënuar me vendimin nr.64, datë 30.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Mat, i falen 9 muaj nga dënimi i mbetur.

19. Enver Sali Diva, dënuar me vendimin nr.46, datë 25.7.2001 të Gjykatës së Rrethit Krujë, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

20. Fation Enver Hasa, dënuar me vendimin nr.323, datë 4.4.2003 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, i falet dënimi i mbetur.

21. Fredi Petref Vrenozi, dënuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Fier, nr.113, datë 24.3.2000, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

22. Kastriot (Esat) Reshat Bogdani, dënuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Librazhd, nr.50, datë 14.7.2000, i falet dënimi i mbetur.

23. Alfred Gjovalin Deda, dënuar me vendimin e Gjykatës së Lartë Tiranë, nr.20, datë 2.2.2000, i falen 1 vit e 3 muaj nga dënimi i mbetur.

24. Engjell Jonus Bakiasi, dënuar me vendimin nr.23, datë 10.2.2003 të Gjykatës së Rrethit Kavajë, i falen 1 vit e 3 muaj nga dënimi i mbetur.

25. Avdil Enver Dule, dënuar me vendimin nr.51, datë 13.11.2002 të Gjykatës së Rrethit Sarandë, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

26. Dashmir Liman Muça, dënuar me vendimin nr.262, datë 11.11.2004 të Gjykatës së Rrethit Elbasan, i falen 1 vit e 6 muaj nga dënimi i mbetur.

27. Fatos Bajram Merka, dënuar me vendimin nr.191, datë 11.9.2003 të Gjykatës së Rrethit Fier, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

28. Lorenc Bajram Merka, dënuar me vendimin nr.191, datë 11.9.2003 të Gjykatës së Rrethit Fier, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

29. Flamur Ymer Pisha, dënuar me vendimin nr.258, datë 13.11.2003 të Gjykatës së Rrethit Elbasan, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

30. Gëzim Gjon Pergjegji, dënuar me vendimin nr.11, datë 29.3.2000 të Gjykatës së Rrethit Mirditë, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

31. Jalmario Mitat Ferko, dënuar me vendimin nr.303, datë 24.12.2003 të Gjykatës së Rrethit Fier, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

32. Artur Vesel Bejtja, dënuar me vendimin nr.55, datë 24.7.1998 të Gjykatës së Rrethit Krujë, i falen 3 vjet nga dënimi i mbetur.

33. Gjovalin Preng Prendi, dënuar me vendimin nr.23, datë 9.4.2001 të Gjykatës së Rrethit Pukë, i falet dënimi i mbetur.

34. Vitore Ndue Prendi, dënuar me vendimin nr.23, datë 9.4.2001 të Gjykatës së Rrethit Pukë, ndryshuar me vendimin e Gjykatës së Lartë nr.48, datë 23.1.2002, i falet dënimi i mbetur.

35. Martin Thoma Tila, dënuar me vendimin nr.153, datë 28.5.2003 të Gjykatës së Rrethit Korçë, ndryshuar me vendimin e Gjykatës së Lartë nr.81, datë 18.2.2004, i falen 1 vit e 5 muaj nga dënimi i mbetur.

36. Julian Dëfrim Gjoça, dënuar me vendimin nr.45, datë 26.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë, i falet dënimi i mbetur.

37. Armir (Ermir) Mirash Bregu, dënuar me vendimin nr.43, datë 14.4.1999 të Gjykatës së Rrethit Shkodër, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

38. Iljaz Feim Jarua, dënuar me vendimin nr.244, datë 6.11.2003 të Gjykatës së Rrethit Fier, i falet dënimi i mbetur.

39. Gazmir Ruzhdi Methasa, dënuar me vendimin nr.65, datë 23.11.2001 të Gjykatës së Rrethit Librazhd, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

40. Bledar Shyqyri Vora, dënuar me vendimin nr.36, datë 27.1.2004 të Gjykatës së Rrethit Durrës, ndryshuar me vendimin nr.110, datë 8.4.2004 të Gjykatës së Apelit Durrës, i falet dënimi i mbetur.

41. Indrit Qemal Filja, dënuar me vendimin nr.20, datë 12.7.2004 të Gjykatës për Krimet e Rënda Tiranë, ndryshuar me vendimin nr.8, datë 23.9.2004 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, i falet dënimi i mbetur.

42. Olsi Sefer Kullolli, dënuar me vendimin nr.369, datë 2.7.2003 të Gjykatës së Rrethit Durrës, i falet dënimi i mbetur.

## Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Alfred Moisiu**

## VENDIM Nr.735, datë 25.11.2005

### **PËR “DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.229, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT ZYRTAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 pika 2 dhe 49 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në vendimin nr.229, datë 23.4.2004 “Për miratimin e Ceremonialit Zyrtar të Republikës së Shqipërisë”, të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 3 të kapitullit VII bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Emërtimi i titullit të kësaj pike ndryshon nga “Ceremonia e festës kombëtare”, në “Ceremoniali për festat e Pavarësisë dhe çlirimit të Atdheut”.

b) Në fillim të përmbajtjes së pikës 3 shtohet një paragraf i ri “3.a”, me këtë përmbajtje:

“3.a Në përkujtim të festave zyrtare të Pavarësisë dhe të çlirimit të Atdheut, Protokolli i Shtetit organizon çdo datë 28 Nëntor të çdo viti, gjatë gjithë ditës këto aktivitete përkujtimore:

a) Ceremoni në nderim të dëshmorëve të kombit:

b) Pritje shtetërore.

3.a.1 Ceremonia e nderimit të dëshmoreve të kombit: Në nderim të dëshmorëve të kombit, Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes, Prefekti, Kryetari i Bashkisë, kryetari i Këshillit të Qarkut, si dhe organizatat e veteranëve vendosin kurora në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë, ora 10:00. Ceremoniali zhvillohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në pikën 5 të këtij kapitulli për nderimin e dëshmorëve të kombit. Një herë në 5 vjet kjo ceremoni transferohet në qytetin e Vlorës dhe zhvillohet sipas ceremonialit të përcaktuar në pikën 2 të këtij kapitulli.

Çdo 28 Nëntor vendos një kurorë edhe trupi diplomatik i akredituar në Republikën e Shqipërisë. Gjatë ceremonisë së vendosjes së kurorës nga dekani i trupit diplomatik, marshe funebre shoqërojnë ecjen dhe himni kombëtar ekzekutohet në fund të ceremonisë. Në ceremoni nuk ka truporje nderi.”.

2. Paragrafi 3.1, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3.1 Pritja shtetërore: Pritja shtetërore me rastin e festave zyrtare të Pavarësisë dhe të çlirimit të Atdheut organizohet në Pallatin e Brigadave, çdo 28 Nëntor, ora 19.30.”.

3. Në pikën 5 të kapitullit VII, të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi 5.1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5.1 Në nderim të dëshmorëve të kombit, më 5 Maj të çdo viti, Presidenti i Republikës,

Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes, Prefekti, Kryetari i Bashkisë, kryetari i Këshillit të Qarkut, si dhe organizatat e veteranëve, vendosin kurora në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë.”.

b) Paragrafi 5.6 shfuqizohet.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.88, datë 16.11.2005**

**“PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN E SUBJEKTEVE  
JOBANKA””**

Në mbështetje të nenit 1 pika 3 të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë ndryshimet në rregulloren “Për licencimin e subjekteve jobanka”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 26.11.03 të Këshillit Mbikëqyrës si më poshtë vijon :

Pika 1. 4 bëhet pika 1.4.1 dhe shtohet një pikë tjetër, me këtë përmbajtje:

“1.4.2 Përfshihet nga pika 1.4.1. subjektet që kryejnë vetëm veprimtarinë e qirasë financiare nuk konsiderohen si subjekte jobanka, sipas përcaktimit të dhënë në këtë rregullore. Veprimtaria e këtyre subjekteve rregullohet në bazë të ligjit nr.9396, datë 12.05.2005 “Për qiranë financiare” dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.”

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI  
**Ardian Fullani**

**VENDIM**  
**Nr.89, datë 16.11.2005**

**“PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN “PËR BLERJET DHE SHËRBIMET NË VLERË  
TË VOGËL NË BANKËN E SHQIPËRISË””**

Në mbështetje të nenit 43 shkronjat (c) dhe (g) të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Administrimit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

**V E N D O S I :**

1. Në udhëzimin “Për blerjet dhe shërbimet në vlerë të vogël në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.16, datë 26.2.2003 dhe ndryshuar me vendimin nr.40, datë 28.5.2003 të Këshillit Mbikëqyrës, të bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Në gjithë përmbajtjen e udhëzimit fjalët “shërbime” ose “lloj shërbimesh” të zëvendësohen

me fjalën “artikull” dhe emërtimi “Departamenti i Shërbimeve Logjistike” të zëvendësohet me emërtimin “Departamenti i Administrimit”.

- Në pikën 1 të udhëzimit, fjalët “lloj shërbimi” pas fjalës “artikuj” të hiqen.

- Pika 2 e udhëzimit bëhet :

- Në kuptimin e këtij udhëzimi, me artikull duhen kuptuar ato mallra apo shërbime, të cilat do të plotësojnë njëkohësisht tre kushte: (i) të kenë të njëjtin emër; (ii) të kenë të njëjtat specifikime teknike; (iii) të kryejnë të njëjtin funksion.

- Në pikën 3 të udhëzimit, fjalët “grup mallrash dhe shërbimesh” të zëvendësohen me fjalët “grup artikujsh”. Në këtë pikë, në fjalinë e dytë të hiqen fjalët “lloje shërbimesh”.

- Në pikën 5 të udhëzimit, fjalët “llojet e mallrave apo shërbimeve”, të zëvendësohen me fjalët “artikujt që do të prokurohen”.

- Në fjalinë e parë të pikës 6 të udhëzimit, fjalët “ose të shërbimeve” të hiqen.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI  
Ardian Fullani

**VENDIM**  
**Nr.90, datë 16. 11. 2005**

**“PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR PROKURIMIN E MALLRAVE, TË SHËRBIMEVE DHE TË NDËRTIMEVE NË BANKËN E SHQIPËRISË””**

Në mbështetje të nenit 43 shkronjat (c) dhe (g) të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Administrimit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

1. Në rregulloren “Për prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe të ndërtimeve në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.15, datë 26.02.2003 dhe ndryshuar me vendimin nr.48, datë 18.06.2004 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në kreun VIII “Realizimi i procedurës së prokurimit” neni 4, përkufizimi i fondit limit të ndryshojë në:

"Fond limit" nënkupton vlerën monetare, që përcaktohet nga kryetari i Entit Prokurues, për realizimin e objektit të prokurimit, referuar buxhetit të Bankës së Shqipërisë dhe studimit të tregut, të realizuar nga sektori i prokurimit.

b) Në kreun VIII “Realizimi i procedurës së prokurimit” neni 51, shtohen paragrafët me përmbajtjen e mëposhtme:

**Neni 51**  
**Sektori i prokurimeve**

Sektori i prokurimeve, për efekt të kësaj rregulloreje, ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore:  
Rishikon fondin limit të përcaktuar në buxhet dhe të paraqitur nga departamenti kërkues sipas nenit 45/ç të kësaj rregulloreje, duke u mbështetur në studimin e tregut, në përvojën e mëparshme të Entit Prokurues, si dhe në bazë të çmimeve të publikuara nga INSTAT dhe institucione të tjera shtetërore përkatëse. Rezulati i nxjerrë nga studimi i tregut duhet të bazohet në jo më pak se dy oferta.

Në rastet kur pas procedurës së rishikimit të fondit siç përcaktohet më lart, fondi i nevojshëm për objektin konkret të prokurimit rezulton më i ulët se fondi i paraqitur nga departamenti kërkues, për realizimin e këtij objekti do të përdoret fondi i rishikuar.

2. Në rregullore zëvendësohet në çdo rast emërtimi “Departamenti i Shërbimeve Logjistike”

me emërtimin “Departamenti i Administrimit”.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI  
**Ardian Fullani**

**Fletorja Zyrtare gjendet:** duke u abonuar pranë: njërive postare të qyteteve;  
Qendrës së Publikimeve Zyrtare;  
- në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"  
Tel: 042 555 63; 267 468  
[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al) ose [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

**REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR  
NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005**

1. Regjistri i depozitimit të parave ose vlerave të tjera
2. Regjistri i përgjithshëm i akteve dhe i veprimeve materiale
3. Regjistri i testamenteve
4. Indeksi alfabetik

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

|                                                                            |      |
|----------------------------------------------------------------------------|------|
| 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....                                              | 1500 |
| 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005) .....                                 | 600  |
| 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë, Vëllim i II-të, Botim 2005).... | 1500 |
| 4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....                                             | 1500 |
|                                                                            |      |
| 1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...     | 1500 |
| 2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....        | 2000 |

**BOTIME TË REJA**

1. KODI DOGANOR
2. KODI DETAR

Doli nga shtypi më 25.11.2005

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4300 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"  
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë